



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 4 datë 30/01/1998

**PER  
FINANCIMIN NGA TE ARDHURAT E BASHKISE PER BLERJE  
MEDIKAMENTESH PER SHERBIMIN E  
ONKOLOGJISE SHTEPIAKE.**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.30.01.1998, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mjedisit “Për financimin nga të ardhurat e Bashkisë për blerje medikamentesh për shërbimin e onkologjisë shtëpiake”, dhe në mbështetje të ligjit Nr.7776, dt.22.12.1993 “Për buxhetin lokal” dhe ligjit Nr.7572, dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”

**V E N D O S I**

1. Dhënien e fondit nga të ardhurat e Bashkisë për shërbimin e Onkologjisë shtëpiake pranë Drejtorisë së Shëndetit Publik për blerje medikamentesh me vlerë 500.000 lekë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mjedisit, dhe Drejtoria e Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**ORHAN SAKIQI**